REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova
12471 2019
03-04-2019
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISHTINA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

*DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA*

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

# KONKURS

I
**Titulli i punës:** Vozites

**Institucioni:** MKRS

**Kategoria funksionale :** Koeficienti: 6

**Numri i referencës: 21/2019**

**I përgjigjet:** Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike

**Vendi:** Prishtinë

**Lloji i kontratës**: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (Kohëzgjatja 6 muaj).

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike, përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Ofron transport sipas nevojave të stafit te administratës së MKRS-se;
2. Sipas nevojës, ofron transport për të ftuarit e Ministrisë;
3. Bënë kontrollimin elementar teknik në mënyrë të kohëpaskohshme, të veturave të Ministrisë;
4. Shpërndan dokumentet nga MKRS në institucione tjera;
5. Kujdeset për mirëmbajtjen e veturave dhe pastërtinë e tyre;
6. Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës se shefit të logjistikës.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Diplome e Shkollimit te Mesëm;

2. Së paku 1(një)vit, përvojë pune;

3. Aftësi të mjaftueshme që herë pas here, të merret me disa çështje , të cilat nuk janë parapare në udhëzime, por që lidhen me nevojat e institucionit;

4. Aftësi te mira komunikuese, me punonjësit tjerë të njëjtit nivel, në njësinë organizative brenda institucionit, ose me persona të tjerë , me qëllim të shkëmbimit të informatave;

5. Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesë (5) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 07.04.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 , ( apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org.